

Република Северна Македонија
ОСНОВЕН ГРАЃАНСКИ СУД СКОПЈЕ
СПИ-1/23
10.01.2023 година
С к о п ј е

Republika e Maqedonisë së Veriut
GJYKATA THEMELORE CIVILE SHKUP
QLI-1/23
viti.10.01.2023
Sh k u p

Në pajtim me nen. 36 nga Ligji për qasje të lirë në informata me karakter publik (Gazeta zyrtare e R.M.S nr.101/19 nga 22.05.2019 vit.) **GJYKATATHEMELORE SHKUP**, me seli në bul.Goce Dellçev nr.4 në Shkup, kontakt telefoni 02/3120171, fax 02/5115-382, e-mail: osnovensudskopje2@osskopje2.mk dhe portparol@osskopje2.mk, përmes kryetarit të gjykatës Ilir Sulejmani dhe nëpunësve zyrtar për ndërmjetësim me informata me karakter publik-Svetllana Zhupanovska dhe Krstana Kostadinovska, e pregaditën:

RAPORT VJETOR
Për zbatimin e LQLKIP për vitin 2022
(periudha nga 01.01.2022 deri 31.12.2022 vit)

1.Të dhëna për personat zyrtarë të përcaktuar për ndërmjetësimin e informatave te poseduesit e informatave;

Në periudhen e caktuar për personat zyrtarë për ndërmjetësimin e informatave me karakter publik janë përcaktuar personat : Svetllana Zhupanovska –bashkëpunëtor gjyqësor me vendim të gjykatës Agj-02-75/20 nga viti 16.09.2020 dhe Krstana Kostadinovska –bashkëpunëtor gjyqësor me vendim të gjykatës Agj-02-64/21 nga viti 07.09.2021.Vendimet janë në fuqi nga dita e sjelljes së tyre.

2. Numri i kërkesave të pranuar;

Gjatë vitit 2022, gjegjësisht në periudhën nga viti 01.01.2022 deri më vitin 31.12.2022 të pranuar gjithsej **27** (njëzet e shtatë) kërkesa për qasje të informatave me karakter publik.

3. Numri i kërkesave të përgjigjura pozitivisht;

3.1. Numri i kërkesave të përgjigjura pozitivisht gjithsej **22** (njëzet e dy). Bëhet fjalë për vendime të sjellura me të cilën janë aprovuar kërkesat për qasje të lirë në informata me karakter publik.

3.2. Krahas këtyre vendimeve, me rastin e **1-kërkese** është sjellur vendim QLI-7/22 nga 29.04.2022 vit.me të cilën është aprovuar pjesërisht kërkesa për qasje në informata me karakter publik parashtruar më 15.04.2022 vit nga kërkuesi M.Ç. nga Shkupi, kështu që i është dhënë informatë e karakterit publik në masën që i përgjigjet rezultateve e testit të zbatuar të dëmshmërisë nga 19.04.2022 vit dhe është refuzuar qasje në pjesën tjetër të informatave të kërkuara. Vendimi është sjellur në pajtim me nen.20 dhe 25 n.l me nenin 6 paragraf 1 pika 4 nga Ligji për qasje të lirë në informata me karakter publik.

4. Numri i kërkesave të hedhura dhe refuzuara duke i theksuar arsyet për secilën kërkesë të hedhur dhe refuzuar, si dhe të tërhequra dhe përcjellura në kompetenc.

4.1. Kërkesa të refuzuara **nuk ka.** Më sipër në pikën 3.2. nga raporti është theksuar kërkesa e cila në një pjesë është refuzuar me vendim QLI-7/22 nga viti 29.04.2022, gjegjësisht kërkesa për qasje në informata me karakter publik parashtruar në vitin 15.04.2022 nga kërkuesi M.Ç. nga Shkupi pjesërisht është aprovuar dhe kërkuetit i është dhënë informatë e karakterit publik në masën që i përgjigjet rezultateve të testit të dëshmërisë në disa etapa nga viti 19.04.2022, por që është refuzuar kërkesa në një pjesë, gjegjësisht refuzohet qasja deri tek pjesa tjetër e informacionit të kërkuar. Përkatësisht në rastin konkret është konstatuar se bëhet fjalë për procedurë civilo-juridike si interes që mbrohet. Përjashtimi nga qasja e lirë në informacion është parashikuar në nenin 6 paragrafi 1 pika 4 të Ligjit për qasje të lirë në informata me karakter publik, dispozitë e cila korrespondon me interesin e përcaktuar mbrojtës. Duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret gjatë aprovimit të testit të dëshmërisë, është vërtetuar se mund të mundësohet qasje e pjesërishtme deri tek informata e kërkuar dhe ndryshim të mënyrës së njoftimit me informatën, në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe në këtë mënyrë kërkuetit ti jepet informacion në sasi me të cilën nuk do të cenohet interesi mbrojtës.

4.2. Të hedhura gjithsej **3 (tre)** kërkesa:

-Me vendim QLI-4/22 nga viti 16.02.2022 është hedhur poshtë kërkesa e kërkuetit V.U nga Shkupi me arsyetim që kërkueti është palë në procedurë gjyqësore dhe të drejtën e tij të informatës, kqyrje ose kopje nga aktet e lëndës mund ta realizojë në pajtim me Ligjin për Procedurë Kontestimore dhe rregullores Gjyqësore. Pas kësaj, në vendimin është theksuar se qëllimi i LQLKIP-së është që personave fizik dhe juridik iu mundësohet që ta realizojnë të drejtën për qasje të lirë në informata me karakter publik të iu sigurojnë në mënyrë të hapur dhe publike në punën e organeve, e cila në asnjë mënyrë nuk duhet të interpretohet në kuptim të zbatimit të pa bazë dhe papërshtatshëm ligjor që nëpërmjet parashtrimit të kërkesës për qasje në informata dhe karakter publik, pala në mënyrë plotsuese të kërkojë të marrë veprime procesuale të cilat janë të parapara në akte tjera ligjore.

-Me vendim QLI-6/22 nga viti 11.03.2022 është hedhur poshtë kërkesa e kërkuetit M.N nga Shkupi nga të njejtat arsye si në vendimin e mëparshëm;

-Me vendim QLI-22/22 nga viti 20.10.2022 është hedhur poshtë kërkesa e parashtruar nga kërkueti F.M. nga Shkupi nga të njejtat arsye sikur në dy vendimet e mëparshme ;

4.3. Një (1) kërkesë është **tërhequr** nga ana e kërkuetit, gjegjësisht nga parashtruesi i kërkesës.

5. Numri i kërkesave të papërgjigjura ;

Kërkesa të papërgjigjura të evidentuara në regjistrin për evidencë QLI për vitin 2022 nuk ka. Domethënë pas të gjitha kërkesave për LQLKIP të pranuar pran kësaj gjykate në vitin 2022 është vepruar dhe përgjigjur.

6. Numri i ankesave të parashtruara kundër vendimeve të shkallës së parë (vendime të poseduesve të informatës, me përshkrim të vendimit, si dhe theksimin e arsyeve për vendimin e sjellur në rast të refuzimit të përsëritur të informatës së kërkuar);

Në vitin 2022 nuk është parashtruar asnjë ankesë në Agjensinë për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informata me karakter publik, e cila i referohet vendimit të Gjykatës Themelore Civile Shkup.

7. Numri i ankesave të pranuar me vendim të Agjencisë;

Nuk ka ankesa të pranuar me vendim të Agjencionit.

8. Numri i vendimeve të rishikuara të shkallës së parë pas veprimeve të Agjencisë;

Nuk ka vendime të ndryshuara të shkallës së parë pas veprimeve të Agjencisë.

9. Numri i ankesave të refuzuara nga Agjencioni dhe arsyet për refuzimin e tyre;

Nuk ka ankesa të refuzuara nga Agjencia.

10. Numri i ankesave të hedhura poshtë nga Agjencioni dhe arsyet për hedhjen e tyre;

Nuk ka ankesa të hedhura nga Agjencioni kundër vendimeve të Gjykatës Themelore Civile Shkup.

11. Në bashkangjitje të këtij raporti janë linqet nga veb faqja e Gjykatës sipas të dhënave të nenit 10 nga Ligji për qasje të lirë në informata me karakter publik.

Shkup, 10/01.2023 vit.

**Kryetari i Gjykatës,
Ilir Sulejmani**

Personat zyrtarë për ndërmjetësimin e informatave me karakter publik,

Krstana Kostadinovska dhe

Svetllana Zhupanovska